

KfW Bankengruppe, Postfach 111141, 60046 Frankfurt am Main

Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
Bul. "D. Kombit", Nr. 3  
Tiranë / Shqipëri  
Faks: (+355) 4 222 8494

Fondi Shqiptar i Zhvillimit  
Rr. "Sami Frasheri", Nr. 10  
Tiranë / Shqipëri

» **Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë  
Dokument ndryshues i Marrëveshjes së Huasë  
dhe Programit ndërmjet KfW Frankfurt am Main,  
Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga  
Ministria e Financave, dhe Fondit Shqiptar të  
Zhvillimit, për financimin e "Fondit të Investimeve  
Sociale IV"**

**Marrëveshja e Huasë dhe Programit**  
**Data** 23 dhjetor 2010  
**Vlera** 20 milionë Euro  
**BMZ-nr.** 2010 65 721  
**Nr. i llogarisë së Huasë** 24916

Datë: 30 Prill 2018

Banka e Zhvillimit KfW

Eva Niepagenkemper  
Referenca jonë.: NgE

Nr. Tel.: +49 69 7431 - 7655

Faks: +49 69 7431-2944

Eva.Niepagenkemper@kfw.de

siç është ndryshuar herë pas here ("Marrëveshja e Huasë dhe Programit").

Të nderuar zotërinj,

I referohemi Marrëveshjes së lartpërmendur të Huasë dhe Programit dhe shkresave tuaja me datë 15 dhjetor 2017 dhe 26 mars 2018, ku kërkonit zgjatje të afatit të disbursimit dhe përshtatje të emërimit dhe adresës së Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë.

Kemi kënaqësinë t'iu informojë me anë të kësaj shkrese se mund ta plotësojmë kërkesën tuaj për zgjatje të afatit të disbursimit deri në 30 tetor 2018. KfW, për të mundësuar përmbylljen e suksesshme të projektit në fjalë, do të marrë përsipër, vetëm për këtë rast, kostot shtesë të rifinancimit të shkaktuara nga shtyrja e afatit të disbursimit.

Rrjedhimisht, ne biem dakord për modifikimet e mëposhtme në Marrëveshjen e Huasë dhe Programit:

#### Seksioni A – Modifikime të Marrëveshjes së Huasë dhe Programit

Marrëveshja e Huasë dhe Programit do të modifikohet si më poshtë:

1. Sa herë që në të gjithë tekstin e Marrëveshjes së Huasë dhe Programit përmendet emërtimi "Ministria e Financave" të fshihet dhe të zëvendësohet me emërtimin "Ministria e Financave dhe Ekonomisë".

2. Neni 3.2 *Afati për kërkimin e disbursimit* të hiqet dhe të zëvendësohet si më poshtë:

"KfW mund të refuzojë disbursimin pas datës 30 tetor 2018."

3. Në nenin 13.2, adresa e Huamarrësit për dërgimin e njoftimeve të hiqet dhe të zëvendësohet si më poshtë:

"Për Huamarrësin: Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
Bulevardi "Dëshmoret e Kombit", Nr. 3  
Tiranë / Shqipëri  
Faks: (+355) 4 222 8494"

#### Seksioni B – Dispozita shtesë

1. Kjo shkresë nuk ndryshon apo tërheq dispozita të Marrëveshjes së Huasë dhe Programit, përveç nëse përcaktohet shprehimisht në këtë Shkresë.
2. Dispozitat e Nenit 10 (*Kostot dhe pagesat publike*), Nenit 11.5 (*Pajtueshmëria*), Nenit 13.2 (*Adresat*), Nenit 14.3 (*Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet*), Nenit 14.4 (*Forma e shkruar*), Nenit 14.6 (*Ligji i zbatueshëm*) dhe Nenit 14.9 (*Mosmarrëveshjet ligjore*) të Marrëveshjes së Huasë dhe Programit, të datës 23 dhjetor 2010, të përfshihen në këtë Shkresë sikur të ishin përcaktuar plotësisht

në këtë Shkresë, dhe sikur referencat në këto pika të Marrëveshjes të ishin referenca për këtë Shkresë.

Ju lutem konfirmoni pëlqimin tuaj për ndryshimet e përmendura më sipër, duke nënshkruar në një formë të detyrueshme ligjore dhe duke i dërguar KfW-së kopjen origjinale.

Përgatitur në 3 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Me respekt,

KfW

Dr. Kirk Mildner  
Drejtuues Divizioni  
Banka e Zhvillimit KfW

Christina Kern  
Menaxhere Projekti  
Banka e Zhvillimit KfW

Lexuar dhe rënë dakord:

Tiranë, 24/07/2018

Tiranë, \_\_\_\_\_ 2018

Për dhe në emër të  
Republikës së Shqipërisë

Për dhe në emër të Fondit Shqiptar të  
Zhvillimit

Emri:  
Titulli:

Emri:  
Titulli: